

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**“ARBERSPERIA” Sh.p.k**

*I. THEMELIMI*

**NENI 1  
Ortakët themelues**

Sot me date, 10/10/2022, Shoqëria krijohet nga ortakët themelues:

- Z. Vito De Matteis, shtetas italian, lindur më 24.05.1979 në Lecce, Itali identifikuar me dokument identifikimi italian nr. 159631 dhe numër personal CA97403MX, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.
- Z. Fabrizio Antonio Leo, shtetas italian, lindur më 27.02.1959 në Melendugno, Itali identifikuar me dokument identifikimi italian nr. 173217 dhe numër personal CA63777EO, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.
- Z. Gianpaolo Tommasi, shtetas italian, lindur më 17.10.1973 në Galatina, Itali identifikuar me dokument identifikimi italian nr. dhe numër personal AY9932335, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.
- Z. Vincenzo Spedicato, shtetas italian, lindur më 24.02.1963 në Calimera, Itali identifikuar me dokument identifikimi italian nr. dhe numër personal AU7322596, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

*II. EMERTIMI – SELIA – FORMA JURIDIKE - OBJEKTI*

**NENI 2  
Emertimi**

Shoqëria emërtohet **“ARBERSPERIA” Sh.p.k**

**NENI 3  
Forma juridike**

Forma juridike do të jetë “Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k.) sipas Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**NENI 4  
Selia**

4.1 Shoqëria **“ARBERSPERIA” Sh.p.k** e ka selinë e saj në adresën: *“TIRANE, Njesia nr.7, Rruga “Mihal Duri”, nr.91/1 1023.”*

4.2 Shoqëria vepron si person juridik shqiptar dhe si e tillë mund të kryejë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet filialeve, degëve, zyrave të përfaqësimit ose agjensitë e saj, të cilat janë krijuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë dhe do të veprojnë nën mbikqyrjen e Administratorëve/Administratorit të **“ARBERSPERIA” Sh.p.k.**

## NENI 5 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë

5.1. Shoqëria “**ARBERSPERIA**” Sh.p.k ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet dhe rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.2. Veprimtaria e Shoqërisë “**ARBERSPERIA**” Sh.p.k, do të ketë për objekt *“Promovimi i panairove tregtare dhe konferencave që lejojnë takimin midis prodhuesve dhe përdoruesve të produkteve dhe/ose shërbimeve, gjithashtu nëpërmjet përdorimit dhe menaxhimit të ambienteve të ekspozitës.*

*Shoqëria ka si objekt edhe aktivitetet e mëposhtme:*

- *Menaxhimi i qendrave të ekspozitës dhe veçanërisht i pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të përdorura për qëllime dhe përdorime për ekspozita, konferenca dhe shfaqje, si dhe shërbimet thelbësore që lidhen me to si ato teknike, IT, shërbime promovuese etj.*
- *Planifikimi, realizimi, promovimi dhe menaxhimi i panairove lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.*
- *Organizimi dhe tregtimi i shërbimeve të përhershme të informacionit të tregut për kompanitë lokale, kombëtare ose ndërkombëtare dhe shoqatat tregtare të lidhura me to.*
- *Promovimi, organizimi dhe administrimi, i aktiviteteve të konferencave, kongreseve, ekspozitave, kulturore, argëtuese etj.*
- *Aktivitetet kolektive të hotelierisë, drejtpërdrejt dhe përmes subjekteve të tjera, të destinuara si administrimi i pijeve dhe ushqimeve të freskëta, të ngrira etj.*
- *Aktivitetet e organizimit, duke përfshirë panairët tregtare, të tilla si ndërtimi, dhënia me qira dhe shitja e orendive, stendave të panairove dhe artikujve plotësues; ruajtjen dhe menaxhimin e pajisjeve dhe materialeve të palëve të treta për përgatitjen e stendave dhe shërbimeve shtesë;*
- *Menaxhimi i shërbimeve logjistike, teknike dhe mbështetëse që kanë të bëjnë me përgatitjen e strukturave teknike dhe montimin e stendave.*
- *Menaxhimin e parkingjeve dhe zonave të pushimit.*
- *Veprimtarinë botuese me përjashtim të edicionit të gazetave ose periodikëve të ngjashëm me to.*
- *Shitjet e hapësirave reklamuese dhe ekspozuese brenda ambienteve të ekspozitës të zgjedhura për ngjarjet.”*
- *Tregtimi i produkteve ushqimore, pa përjashtim, te freskëta, frigoriferike, te ngrira dhe te konservuara.*
- *Shpërndarja e produkteve dhe shërbimeve në biznesin e hotelierisë, si dhe furnizime me mobilje, pajisje, pajisje elektrike dhe objekte hotelierie në përgjithësi;*
- *Tregtimin, importin, eksportin e peshkut dhe të bagëtive në përgjithësi, si dhe përpunimin, konservimin dhe përgatitjen e mishit dhe produkteve të mishit, peshkut dhe produkteve të tij, të freskëta, frigoriferike, të ngrira etj.*
- *Tregtia me pije joalkoolike, alkoolike.”*

5.2.2 Shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë cdo operacion tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj;

5.2.3 Shoqëria, me vendim të Administratorit, mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë cdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.

5.3 Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë, të zgjerohet ose të pakësohet në bazë të vendimit të Asamblese së Përgjithshme.

### *III. KOHEZGJATJA – KAPITALI I SHOQERISE-VENDIMARRJA*

#### **NENI 6 Kohezgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar deri më 31 dhjetor 2072 (dy mijë e shtatëdhjetë e dy) dhe mund të zgjatet me formalitetet e kërkuara nga ligji.

#### **NENI 7 Kapitali i Shoqërisë**

7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë “**ARBERSPERIA**” Sh.p.k përfaqësohet nga 4 (Kater) kuota, në vlerën totale 466,000 (Katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) Lek, e kundërvlefshme me 4000 eur (Katër mijë) dhe nuk është paguar.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë:

- Z. Vito De Matteis, Zotërues i një kuote dhe 25% të kapitalit të shoqërisë në vlerën 116,500 lek.
- Z. Fabrizio Antonio Leo, Zotërues i një kuote dhe 25% të kapitalit të shoqërisë në vlerën 116,500 lek.
- Z. Gianpaolo Tommasi, Zotërues i një kuote dhe 25% të kapitalit të shoqërisë në vlerën 116,500 lek.
- Z. Vincenzo Spedicato, Zotërues i një kuote dhe 25% të kapitalit të shoqërisë në vlerën 116,500 lek.

#### **NENI 8 Asambleja e Përgjithshme**

Vendimet merren nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet që ligji apo Statuti ia rezervon këtij organi, si dhe për çështjet për të cilat, Administratori kërkon mendimin apo miratimin e Asamblesë së Përgjithshme.

8.1 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me shkrim dhe regjistrohen në një regjister të posaçëm të mbajtur pranë selisë së Shoqërisë “**ARBERSPERIA**” Sh.p.k.

8.2 Janë në kompetencën ekskluzive të Asamblesë së Ortakëve marrja e vendimeve për sa i përket:

- ndryshimit të Statutit;
- riorganizimi i shoqërisë, ndarja, bashkimi, likuidimi, shndërrimi i shoqërisë;
- zmadhimi, zvogëlimi i kapitalit, transferimi i pjeseve të kapitalit themeltar tek të tretët, si dhe blerjen e pjeseve të kapitalit themeltar nga vete shoqëria me qëllim anulimin e tyre;
- emërimi dhe shkarkimi i Administratorit;
- emërimi dhe shkarkimi i eksperteve kontabel të autorizuar;
- miratimi e bilancit;
- si dhe të gjitha kompetencat e tjera që ligji dhe/ose Statuti japin shprehimisht Asamblese

**NENI 9**  
**Organet drejtuese**

9.1. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:

- a) Asambleja e Pergjithshme në të cilën marrin pjesë ortakë themeluesë ose përfaqësuesit e tyre të pajisur më prokurë të veçantë; dhe
- b) Administratorët

**NENI 10**  
**Administratori i Shoqërisë**

10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori, person fizik që mund të jetë ose jo ortak i Shoqërisë.


10.2 Administratori është i detyruar të drejtojë Shoqërinë në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Statutin, vendimet e Asamblesë së Pergjithshme dhe sipas dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

10.3 Administratori i Shoqërisë emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Ortakëve, si dhe do të qendrojë në detyrë për një kohë prej 5 (pesë) vjetesh.

10.4 Administratori i parë i shoqërisë emërohet:

- Z. Vito De Matteis, shtetas italian, lindur më 24.05.1979 në Lecce, Itali identifikuar me dokument identifikimi italian nr. 159631 dhe numër personal CA97403MX, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

Nënshkrimi i administratorit



10.5 Administratori ka të gjitha kompetencat që i njeh ligji dhe Statuti i Shoqërisë.

**NENI 11**  
**Ligji i zbatueshem dhe mosmarreveshjet**

11.1 Për sa nuk parashikohet nga ky Akt Themelimi, referencë i bëhet legjislacionit shqiptar në fuqi.

11.2. Për të gjitha mosmarreveshjet brenda shoqërisë që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk mund të zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11.3. Ky dokument redaktohet në 3 (tre) kopje origjinale.

Lexuar, kuptuar, aprovuar e nënshkruar nga ortakët themeluesë: Tirana 10.10.2022.

**ORTAKET THEMELUES**

- Z. Vito De Matteis,
- Z. Fabrizio Antonio Leo
- Z. Gianpaolo Tommasi
- Z. Vincenzo Spedicato

